

Shënimet e pasqyrave financiare

1. Informacion I përgjithshëm

MSE sh.p.k ("Shoqëria") është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e krijuar me datën 01.08.2018. Selia e Shoqërisë është në KASHAR Njesia Administrative Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Kilometri i 8, Rruga Paralele, Ndertese private me zone kadastrale 2105.

Shoqëria është regjistruar në autoritetet fiskale me Numer Identifikimi të Personit të Tatueshem (NIPT/NUIS) L82001005A.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është Tregti me shumicë i pajisjeve mjekësore. Import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakice të instrumentave dhe pajisjeve shëndetësore. Import, eksport, tregtimi me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, implantëve si dhe aksesoreve të tyre edhe gjeneratorëve me Rreze X, instalimi dhe mirëmbajtjen e të gjithë pajisjeve të cituara me sipër. Investime, shërbime, projekte në fushën e mjekësisë dhe shëndetit. Ortaku i kompanisë është Znj. Denisa Bishyti e cila disponon pjesëmarrje në 100 % me vlerëne kapitalit në vlerën prej 2,000,000 Lekë.

Administrator i Shoqërisë është Z. Arber Licaj

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabel

2.1 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Shoqëria mban llogaritë e saj në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe standartet kombëtare të kontabilitetit.

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (të përmirësuara), në ligjin Nr 9228 datë 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ndryshuar me ligjin Nr 9477 datë 09.02.2006, dhe me urdhrin e Ministrit të Financave Nr 64 datë 22.07.2014 dhe në përputhje me politikat kontabel të shoqërisë.

Keto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike dhe parimin e biznesit në vijimësi.

Të dhënat aktuale dhe krahasues janë shprehur në Leke shqiptar, që është monedha raportuese e shoqërisë. Disa riklasifikime janë bërë të nevojshme për vlerat krahasuese për të qenë konform prezantimit të vitit aktual.



2.2 Aktivët afatgjatë materiale dhe jo-materiale

Aktivët afatgjatë materiale dhe jo-materiale janë pasqyruar në librat e shoqërisë me koston e tyre historike minus zhvlerësimin e akumuluar.

Normat vjetore të zhvlerësimit të aplikuar janë si më poshtë:

Aktivët afatgjatë jo-materiale	Normat e zhvlerësimit %	
	2019	2018
Ndertesa	5	5
Makineri dhe pajisje	20	20
Mobilje dhe orëndi	20	20
Pajisje elektronike	20	20
Aktivët afatgjatë jo-materiale		
Programe kompjuterike	25	25

Vlera kontabel e aktiveve afatgjatë materiale dhe jo-materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabel mund të mos jetë e rikuperueshme. Në qoftë se rrethanat të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabel tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktivët ose pjesë të tyre të përfshira në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.3 Aktivët dhe detyrimet financiare

Aktivët dhe detyrimet financiare konsistojnë tërësisht në llogari të arketueshme dhe llogari të pagueshme dhe janë pasqyruar në bilanc bazuar në shumën e faturuar.

Provizionet për borxhet e keqija njihen kur shumën konsiderohen të pambledhshme. Provizionet për borxhet e keqija është vlera e llogaritur nga drejtimi për të absorbuar humbje të mundshme në të ardhmen për llogari të arketueshme ekzistuese që mund të behen të pambledhshme si pasojë e kushteve ekonomike ekzistuese, rrethimeve të qenësishme dhe të cilësive të klientëve dhe faktorëve të tjerë relevant, që sigurojnë njohjen aktuale. Vlera e humbjeve specifikisht të identifikuar (p.sh. kliente të klasifikuar si të dyshimta dhe të humbur) njihen si shpenzime dhe zbriten nga totali i llogaritës së arketueshme për atë klient si provizion për borxhet e keqija.

2.4 Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë para të mbajtura në bankat vendase dhe para në arke në monedhe vendase dhe të huaja dhe paraqiten me kosto.



2.4 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj perkthehen ne Leke dhe regjistrohen duke perdorur kursin zyrtar ne daten e transaksionit. Mjetet monetare dhe zerat e tjere jomonetare ne bilanc te shprehur ne monedhe te huaj jane perkthyer ne Leke me kursin zyrtar te kembimit ne daten e bilancit. Diferencat e kembimit qe rezultojne kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve te shoqerise.

Kursi zyrtar i kembimit per monedhat kryesore per perkthimin e zerave te bilancit te shprehur ne monedhe te huaj paraqiten si vijon (ne Leke):

	<u>31-Dec-19</u>	<u>31-Dec-18</u>
1 EUR	121.77	123.42
1 USD	108.42	107.82

2.5 Te ardhurat dhe shpenzimet

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundshme qe perfitimet e ardhshme ekonomike do te hyjne ne shoqeri dhe keto perfitime mund te maten ne menyre te besueshme

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet per kerkime e zhvillime pergjithesisht jane ngarkuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin

2.6 Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me legjislacionin shqiptar per tatimin mbi fitimin. Tatimi mbi fitimin njihet ne pasqyren e te ardhurave me perjashtim te zerave qe njihen direkt ne kapital ose ne te ardhurat e tjera gjitheperfshirese.

Tatim mbi fitimin eshte tatim fitimi i pritshem mbi te ardhurat e tatueshme per vitin, duke perdorur normat e tatimit ne daten e raportimit, dhe cdo korigjim te tatimit te pagueshem per vitet e kaluara. Tatim fitimi llogaritet me 15 % per vitin 2019 (31.12.18:15%) mbi fitimin e tatueshem

2.7 Detyrime per sigurimet shoqerore

Shoqeria pagan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave kur ndodhin.



2.8 Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlere te drejte, minus koston e transaksionit te ndodhur. Huamarrjet njihen me vone me koston te amortizuar. Cdo difference ndermjet parave te marra (minus koston e transaksioneve) dhe vleres perfundimtare do te njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes duke perdorur metoden e interesit efektiv.

2.9 Kapitali i aksionerëve

Kapitali i aksionerëve përbëhet nga mjetet monetare kontribuar nga themeluesit e shoqerise. Kapitali i aksionerëve kontabilizohet në shumën përkthyer në monedhën vendase të valutës së huaj të kontribuar, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit

2.10 Provigjonet

Një provigjon njihet kur Shoqeria ka një detyrim aktual si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e detyrimit. Provigjonet rishikohen në cdo datë të bilancit të pozicionit financiar dhe rregullohet duke reflektuar vlerësimin më të mirë aktual. Kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material, shuma e provigjonit është vlera e tanishme e shpenzimeve që pritet të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin. Provigjonet nuk njihen për humbjet e ardhshme operative.

2.11 Angazhimet dhe detyrime te kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato paraqiten vetem ne shenimet shpjeguese, perjashto rastet kur mundesia e nje daljeje te burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike eshte e larget. Aktivet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare por paraqiten ne shenime kur nje hyrje e perfitimeve ekonomike eshte e mundur. Vlera e nje humbje te kushtezuar njihet si provizion nqs eshte e mundshme qe ngjarje te ardhshme do ta konfirmojne ate, nje detyrim i lindur ne daten e bilancit kontabel dhe nje vleresim i arsyeshem i vleres se humbjes mund te behet.

2.12 Transaksione me palet e lidhura

Palet e lidhura jane ato ku nje pale kontrollohet nga tjetra ose ka influence te rendesishme ne marrjen e vendimeve financiare ose te biznesit te pales tjeter.



2.13 Ngjarje pas periudhes se raportimit

Ngjarjet pas dates se bilancit qe sigurojne informacion shtese per pozicionin e shoqerise ne daten e pasqyres se pozicionit financiar (ngjarje rregulluese) do te reflektohen ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas dates se bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese do te paraqiten ne shenimet e pasqyrave financiare kur jane materiale.

3. Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve te bilancit**1. Mjetet monetare**

Mjetet monetare jane si vijon:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
<u>Arka</u>		
- ne monedhe vendase	239,828	484
- ne monedhe te huaj	402,309	0
	<u>642,137</u>	<u>484</u>
<u>Llogari rrjedhëse ne banka</u>		
- ne monedhe vendase	951,797	2,086,305
- ne monedhe te huaj	9,005,912	6,245,931
	<u>9,957,709</u>	<u>8,332,236</u>
Transferta ne tranzit midis bankave	-	0
Totali i mjeteve monetare	<u><u>10,599,846</u></u>	<u><u>8,332,720</u></u>

2. Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme perbehen kryesisht nga balanca me kliente vendas.

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Kliente per sherbime dhe mallra	527,677,830	157,723,948
Kliente per aktive afatgjata	0	0
Minus provigjone per borxhin e keq	-	-
Llogari te arketueshme, neto	<u><u>527,677,830</u></u>	<u><u>157,723,948</u></u>

3. Te tjera te drejta te arketueshme

Te tjera te arketueshme jane detajuar si me poshte:

**31 Dhjetor
2019**

31 Dhjetor 2018



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Kapital I nenshkruar I papaguar	1,000,000	1,000,000
Debitore kreditore te ndryshem	477,033	0
TVSH debitore	0	
Shpenzime te shtyra	118,121	0
Paradhenie per blerje	0	0
Totali	1,595,154	1,000,000

4. Inventari

Inventari eshte pasqyruar si me poshte:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Lende e pare	-	-
Mallra per rishitje	70,827,262	3,528,846
Parapagese per inventar	5,387,102	-
Totali	76,214,364	3,528,846

5. Aktivet afatgjata material

	Ndertese dhe Instalime	Makineri dhe paisje	Mjetet e transportit	Paisje zyre dhe informatike	Total
Kosto					
Me 1 Janar 2019	0	0	0	0	0
Shtesat		411,834	3,870,434	1,024,430	5,306,698
Paksimet					0
Me 31 Dhjetor 2019	0	411,834	3,870,434	1,024,430	5,306,698
Zhvleresimi					
Me 1 Janar 2019					0
Zhvleresimi i vitit		-46,639	-329,695	-118,393	-494,727
Paksimet			0	0	0
Me 31 Dhjetor 2019	0	-46,639	-329,695	-118,393	-494,727
Vlera neto kontabel 1 Janar 2019	0	0	0	0	0
Vlera neto kontabel 31 Dhjetor 2019	0	365,195	3,540,739	906,037	4,811,971

6. Aktivët afatgjatë jo-materiale

	Programe dhe Licensa	Totali
Kosto		
Me 1 Janar 2019	0	0
Shtesat	0	-
Me 31 Dhjetor 2019	0	0
Zhvleresimi		
Me 1 Janar 2019	0	0
Zhvleresimi i vitit	0	0
Me 31 Dhjetor 2019	0	0
Vlera neto kontabel 1 Janar 2019	0	0
Vlera neto kontabel 31 Dhjetor 2019	0	0

7. Arketime në avance për porosi

Arketimet në avance për porosi paraqet vlerën e mbetur në fund të vitit për arketimet e faturuara gjatë vitit

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Arketime në avance për porosi	12,968,505	4,888,984
Totali Furnitore	12,968,505	4,888,984

8. Furnitore

Furnitoret përfshijnë kryesisht detyrimet kundrejt furnitoreve vendas. Shuma parapagime ndaj furnitorëve lidhet me pagesa në avancë për mallra që do të vijnë gjatë vitit 2019.

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Furnitore për mallra e shërbime	271,303,910	156,095,655
Furnitore për AAM	0	0
Totali Furnitore	271,303,910	156,095,655



Parapagime ndaj furnitore (shih shenimin 5)	0	0
Furnitor neto	271,303,910	12,225,816

9. Paga dhe sigurime të pagueshme

Detyrimet për pagat dhe detyrime të ngjashme :

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Pagat e punonjesve	714,318	201,576
Sigurime shoqerore	378,303	39,060
Tatim mbi te ardhurat personale	233,646	-
	0	0
Totali i pagave të pagueshme dhe të ngjashme	1,326,267	240,636

10. Te tjera te pagueshme

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Tatim fitimi i pagueshem	25,590,875	713,802
Tatim ne burim	238,772	81,953
TVSH	6,044,498	1,274,205
Shpenzime te telek.+oshee	75,215	-
Dividente per tu paguar	4,867,057	
Totali	36,816,417	0
	2,069,960	

11. Huamarrje

Huamarrjet afatshkurter dhe afatgjate jane detajuar si meposhte:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
<u>Huamarrje afat-gjate</u>		
Hua afatgjate bankare	121,770,000	-
	121,770,000	0
Minus: pjesen afat-shkurter te kredise afat-gjate		
Totali huamarrje afat-gjate	121,770,000	0

Huamarrje afat-shkurtër

Huamarrje te Tjera	10,959,300	0
TOTALI	10,959,300	0

12. Te ardhura te shtyra

Të ardhurat e shtyra janë të ardhura të parapaguar por realizimi i tyre është për një periudhë të ardhshme.

Te ardhura te shtyra 11,448,815

13. Kapitali dhe rezervat***Kapitali***

Me 31 Dhjetor 2019, sipas Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR) totali i kapitalit te regjistruar eshte 2,000,000 Leke.

	2019	2018	%
Denisa Bishyti	2,000,000	2,000,000	100%
Totali i Kapitalit te Regjistruar	2,000,000	2,000,000	100

14. Shitje produktesh

Shoqeria gjate vitit 2019 ka nje rritje te shitjeve. Shitja e produkteve dhe mallrave eshte analizuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Te ardhura nga Shitja	600,948,206	157,475,395
Te tjera	0	0
Totali	600,948,206	157,475,395

Sipas deklarimeve ne tatime rezulton se

Eksportet	7,013,186	0
Shitjet brenda vendit	593,935,020	157,475,395
Totali	600,948,206	157,475,395



Totali I shitjeve	600,948,206
Minus paradhenie klient 2018	- 4,888,984
Plus paradhenia klient 2019	12,968,505
Plus te ardhura te shtyra	11,448,815
Rivleresim I kursit	230,268
Totali I shitjeve ne FDP te TVSH	620,706,810

15. Kostoja e mallrave të shitur

Kostoja e materialeve eshte detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Ndryshime ne prod.gatshem		0
Kosto e mallra të shitura	380,004,503	151,077,423
Kosto e mallrave të shitur	380,004,503	151,077,423

19. Shpenzime personeli

Shpenzimet per personelin perfshijne si vijon:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Paga dhe shperblime	17,144,700	227,000
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	1,997,712	37,909
Totali	19,142,412	264,909

16. Shpenzime administrative dhe te tjera

Shpenzimet administrative dhe të tjera jane ne shumen 23,268,361.00 leke

17. Te ardhurat/(shpenzimet) financiare


Te ardhurat/(shpenzimet) financiare perfshijne fitimet dhe humbjet e realizuara apo te parealizuara nga kurset e kembimit, te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat, dhe te tjera te ardhura financiare si vijon:

	31 Dhjetor 2019
Shpenzime interesi per hua-marrje nga banka	0
Shpenzime nga interesi	0

Fitime (humbje) nga kurset e kembimit

1,353,419





Fitime (humbjet) neto nga kurset e kembimit	1,353,419
Shpenzime te tjera financiare	0
Te ardhura te tjera financiare neto	0
Totali i te ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	1,353,419

18. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatim fitimit rakordon me fitimin kontabël per vitin 2019 si me poshte:

31 Dhjetor 2019

1 Fitimi/(Humbja) para tatimit	179,391,620
2 Te ardhura nga interesi te tatuara ne burim ne Kosove me 10%	-
3 Tatim ne burim i paguar ne Kosove	-
4 Shpenzime te panjohura	1,179,513
5 Penalitete	0
Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2+3+4+5)	180,571,133
6 Humbje te mbartura (-)	
7 Fitimi i tatueshem /(humbje)	180,571,133
Norma e tatimit mbi fitimin	15%
8 Shpenzim tatim fitimi me norme 15%	27,085,670
9 Total shpenzim tatim fitimi	
Tatim fitimi i parapaguar	1,494,795
10 Tatim fitimi i pagueshem	25,590,875

19. Angazhimet dhe detyrime te kushtezuara

Angazhime

Shoqeria nuk ka angazhime materiale te nenkontraktuara ne daten e pasqyres se pozicionit financiar te cilat te mos jene reflektuar ne pasqyrat financiare

Detyrime tatimore

Librat dhe te dhenat kontabel per vitet financiare qe perfundojne me 31 Dhjetor 2019 nuk jane audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim, detyrimet tatimore te Shoqerise mund te mos konsiderohen te finalizuara per vitin qe perfundon me 31 Dhjetor 2019.



20. Ngjarje pas dates se raportimit

Mbas dates 31 Dhjetor 2019 – date e raportimit dhe e aprovimit te pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje materialisht te rendesishme qe te mund te ndikojne ne keto pasqyra fianciare.

21. Gjykimet dhe cmuarjet e rendesishme kontabel

Ne aplikimin e politikave kontabel te Kompanise, qe pershkruhen ne Shenimin nr 2, drejtimit i kerkohet qe te beje gjykime, cmuarje, dhe supozime per vleren kontabel te aktiveve dhe detyrimeve qe nuk jane te qartesisht te dukshme nga burime te tjera. Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to jane te bazuara ne eksperiencen historike dhe faktore te tjere qe konsiderohen te rendesishem. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto cmuarje.

Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to jane rishikuar ne menyre te vazhdueshme. Ndryshimet ne cmuarjet kontabel do te njihen ne periudhen ne te cilen cmuarja eshte rishikuar nqs rishikimi ndikon vetem ate periudhe ose ne periudhen e rishikimit dhe ne periudha te ardhshme nqs rishikimi ndikon periudhen aktuale dhe ato te ardhme.

*Pasiguria ne gjykime**Zhvleresimi i aktiveve jofinanciare*

Humbjet nga zhvleresimi do te njihen ne vleren ne te cilen vlere kontabel e aktiveve ose e njesise gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme. Kur percaktohet vlere e rikuperueshme, drejtimi vlereson cmimet e pritshme dhe flukset e parase nga cdo njesi gjeneruese e parase dhe percakton nje norme interesi te pershtatshme kur llogaritet vlere aktuale e ketyre flukseve te parase.

*Zhvleresimi i aktiveve financiare**Zhvleresimi i llogarive te arketueshme*

Kompania llogarit zhvleresimin per llogarite e arketueshme bazuar ne humbjet e vleresuara qe rezultojne nga paaftesia e klienteve per te bere pagesat e kerkuara. Vleresimi i mjaftueshmerise se humbjes nga zhvleresimi per llogarite e dyshimta eshte bazuar ne analizen e vjetersise te llogarive te arketueshme dhe eksperiencen historike te cregjistrimit, cilesine e klientit dhe ndryshimet ne termat e pageses se klientit. Kjo perfshin supozime per sjelljen e ardhshme te klientit dhe mbledhjet e ardhshme te parave. Nqs kushtet financiare te klientit perkeqsohen, eliminimet aktuale te llogarive te arketueshme ekzistuese mund te jene me te larta se sa priteshin dhe mund te kalojne nivelin e humbjeve nga zhvleresimi te njohura deri tani.

Jeta e dobishme e aktiveve te amortizueshme

Drejtimi rishikon ne menyre te vazhdueshme jeten e dobishme te aktiveve te mbajtura me kosto te amortizuar ne cdo date te pasqyres se pozicionit financiar. Drejtimi vlereson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmerine e pritur te ketyre aktiveve. Vlere e mbetur e ketyre aktiveve eshte analizuar ne Shenimin 7. Rezultatet reale mund te ndryshojne per shkak te konsumimit teknologjik.



Inventari

Inventari është paraqitur me vlerën me të ulet midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Gjate përcaktimit të vlerës së realizueshme neto, drejtimi merr parasysh evidencat me objektive të disponueshme për kryerjen e vlerësimeve.

22. Manaxhimi i riskut financiar**22.1 Faktoret e riskut financiar**

Aktivitetet e Kompanisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie të risqeve financiare, që përfshijnë riskun e kreditit dhe riskun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Manaxhimi i riskut të Kompanisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të Kompanisë.

Manaxhimi i riskut kryhet nga drejtimi bazuar në politikë të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë manaxhimin e riskut, si dhe çështje specifike, si risku i kursit të këmbimit, risku i normës së interesit, risku i kreditit, përdorimi i letrave me vlerë të pershtatshme dhe investimi i likuiditetit të tepert.

22.2 Risku i tregut*Risku i kursit të këmbimit*

Kompania është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit që lind nga ekspozimi kundrejt monedhave të ndryshme të huaja kryesisht në lidhje me Euro. Kompania nuk përdor ndonjë instrument për të mbrojtur ndaj riskut të kursit të këmbimit. Drejtimi i Kompanisë është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të pershtatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet ditore.

Risku i normës së interesit për flukset monetare dhe vlerën e drejte

Shoqëria ka ekspozim për të afektuar fluktuacionet në nivelet e parapirë të normës së interesit të tregut në bilancin kontabel dhe flukset e parase së saj. Drejtimi i kompanisë është përgjegjës për monitorimin mujor të pozicionit të riskut të normës neto të interesit dhe vendos limite për të reduktuar potencialin e fluktuacionit të normës së interesit. Nuk ka përqendrim të fondeve të marra hua me interes nga institucionet financiare ose entitete me norme interesi variabel në datën e raportimit. Fluktuacionet e normës së interesit të tregut me të cilën janë marrë fonde hua mund të ketë efekt negativ në performancën financiare të shoqërisë. Në të njëjtën kohë, shoqëria nuk ka vendosur aktive në depozita me afat dhe në letra me vlerë shumë likuide, duke përfutur të ardhura interesi shtese.

Aktivitet Financiare

Që nuk mbartin interes

Llogari të arketueshme

Llogari të tjera të arketueshme

2019**2018**

527,677,830

157,723,948

1,595,154

1,000,000



Mjete Monetare	10,599,846	8,332,720
	539,872,830	167,056,668
<i>Me norme interesi te pandryshueshme</i>		
Mjete monetare e te tjera	0	0
Detyrime Financiare		
<i>Qe nuk mbartin interes</i>		
Llogari te pagueshme	271,303,910	156,095,655
	271,303,910	156,095,655
<i>Me norme interesi te pandryshueshme</i>		
Huamarrje afat-gjate	121,770,000	0
	121,770,000	0
<i>Me norme interesi variable</i>		
Huamarrje qe mbartin interes variable	0	0
	0	0

Analiza e sensitivitetit te normes se interesit

			2019
	Shum a neto	2%	-2%
Me norme interesi variable	0	0	0

22.3 Risku i kreditit

Risku i kreditit eshte risku i humbjeve financiare per Kompanine nese klienti apo pala tjeter e perfshire ne nje instrument financiar nuk shlyen detyrimet kontraktuale. Ekspozimi i kompanise ndaj riskut te kreditit varet kryesisht nga karakteristikat specifike te cdo debitori.

Kompania krijon nje provizione per zhvleresim qe perfaqsojne vleresimin e saj per humbjet e ndodhura ne lidhje me llogarite e arketueshme bazuar plotesisht ne humbje specifike te lidhura me ekspozime individuale te medha.

Ekspozimi maksimal i kompanise ndaj riskut te kreditit eshte perfaqsuar nga vlerat kontabel te cdo aktivi financiar ne bilancin kontabel te permbledhura si me poshte:

	2019	2018
Klasat e aktiveve financiare – vlerat kontabel:		
Llogari te arketueshme dhe te arketueshme te tjera	627,677,830	157,723,948
Paraja dhe ekuivalentet e saj	10,599,846	8,332,720
	638,277,676	166,056,668

22.4 Risku i likuiditetit


Kompania manaxhon nevojat per likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e skeduluara te borxhit per detyrimet afatgjata financiare si dhe parashikon flukset hyrese dhe dalese per punet e perdritshme. Nevojat per likuiditet monitorohen ne periudha kohore te ndryshme. Kerkesat neto per para krahasohen me huamarrjet e disponueshme ne menyre qe te percaktohet cdo mungese. Kjo analize tregon nese huamarrjet e disponueshme priten te jene te mjaftueshme gjate periudhes se vezhguar. Kompania mban para per te perballuar kerkesat per likuiditet per nje periudhe minimalisht prej 30 ditesh. Nevojat per financim afatgjate plotesohen gjithashtu edhe me nje vlere te pershtatshme huash. Me 31 dhjetor 2019 dhe 2018, detyrimet e kompanise kane maturitete kontraktuale (perfshire pagesat e interesit kur aplikohen) si me poshte:

	Afatshkurtra	1 deri 2 vjet	2 deri 5 vjet	Afatgjata
Me 31 Dhjetor 2019	1 deri 12 muaj			Me shume se 5 years
Huamarrjet - afatshkurter	10,959,300		0	
Huamarrjet -afatgjate	0		126,637,057	
Llogari te pagueshme	271,303,910		0	
	282,263,210		126,637,057	

	Afatshkurtra	1 deri 2 vjet	2 deri 5 vjet	Afatgjata
Me 31 Dhjetor 2018	1 deri 12 muaj			Me shume se 5 years
Huamarrjet - afatshkurter	0		-	
Huamarrjet -afatgjate	-		0	
Llogari te pagueshme	156,095,655		-	
	156,095,655		0	

ADMINISTRATORI

Arbër Liçaj



HARTUESI I PARQYRAVE

Nevila Kurti